

2018

# POLITIKA E PAANSHMËRISË, KONFIDENCIALITET IT DHE KONFLIKTIT TE INTERESIT

**EQSC**

European Quality & Safety Control

Management Systems Certification Body

### 3.1 Politika e Paanshmërisë

EQSC konsideron që synimi i përgjithshëm i procesit të certifikimit është ti jap besim të gjitha palëve të përfshirë në këtë proces si dhe që sistemi i menaxhimit të plotësojë kërkesat e specifikuar. Vlera e certifikimit është niveli i sigurisë së përgjithshme dhe besimi që krijohet nga një vlerësim kompetent dhe i paanshëm nga një palë e tretë.

EQSC konsideron që të arrihet dhe të mirëmbahet besimin është thelbësore që vendimet të bazohen në evidencën objektive të konformitetit dhe që vendimet për certifikimin nuk janë influencuar nga interesa të tjera ose nga palët e tjera.

EQSC është e bindur se garantimi i paanshmërisë është thelbësor për jetëgjatësinë e saj në treg, për tërheqjen e klientëve cilësorë, për përputhjen e veprimtarisë së saj me legjislacionin dhe të mirën e komunitetit.

EQSC në përputhje me sa më sipër përfshin në vetvete Komitetin e Paanshmërisë në përputhje edhe me kërkesat e Standardit ISO 17021. Në këtë organizëm marrin pjesë personalitetet të nderuara dhe me reputacion të gjerë shoqëror e profesional.

#### 3.1.1 Vlerësimi i kërcënimeve për paanshmërinë

EQSC kujdeset që paanshmëria e tij të mos kërcënohet dhe për këtë arsye identifikon burimet e kërcënimit dhe vlerëson masat parandaluese për të eliminuar rrezikun e ndodhjes së këtyre kërcënimeve.

Kërcënimet e identifikuar të paanshmërisë, të vlerësuara nga EQSC përfshijnë sa më poshtë:

- Kërcënimet e lidhura me interesin: kërcënime që lindin prej një personi ose organizmi që vepron bazuar në interesat e ngushta personale. Një kërcënim i paanshmërisë lidhur me certifikimin, i vlerësuar është interesin financiar.
- Kërcënimet e lidhura me vetë-rishikimit: kërcënime që lindin nga një person ose organizëm që rishikon punën e bërë nga ai vetë. Auditimi dhe certifikimi i sistemeve të menaxhimit të një klienti për të cilin EQSC ka dhënë konsulentë në ngritjen dhe mirëmbajtjen e sistemeve të menaxhimit, konsiderohet si një kërcënim i vetë-rishikimit.
- Kërcënimet e lidhura me familjaritetin (ose besimin): kërcënime që lindin nga një person ose organizëm, me të cilin auditori është mjaft familjar ose të cilin i beson, duke pranuar atë që personi komunikon por jo atë që ai mund të provojë apo të evidentojë me prova.
- Kërcënimet e lidhura me frikësimin: kërcënime që lindin nga një person ose organizëm, që ndihet i detyruar nga të tjerët (në formë të hapur apo të fshehtë) për të kryer një proces të paanshëm. Kërcënimet që mund ti jepet këtij personi apo organizmi është për ta zëvendësuar ose raportuar te një mbikëqyrës.

Një analizë e përmbledhur e vlerësimit të kërcënimeve për paanshmërinë, kryhet gjatë Rishikimit të menaxhimit, dhe dokumentohet në FPO.2\_3 Vlerësimi i kërcënimeve për konfliktin e interesit dhe paanshmërinë.

#### 3.1.2 Deklarimi i paanshmërisë

Deklarimi i paanshmërisë është publik për Menaxhimin e lartë (Administratorin) dhe konfidencial për personelin.

Administratori i EQSC, nëpërmjet deklaratës së tij FPO.2\_2 Deklarata e paanshmërisë e menaxhimit të lartë, shpreh qëllimin dhe interesin e EQSC si trupë certifikimi, për të qenë e paanshme dhe jashtë çdo konflikti të interesit, në të gjitha hapat e aktivitetit të saj, si dhe me marrëdhëniet ndërmjet palëve.

Ndërkohë që si Administratori, ashtu edhe të gjithë personat, komitetet, ekspertët e jashtëm, etj. që kanë lidhje me proceset e auditimit dhe certifikimit, duhet që të nënshkruajnë rregullisht (në fillimin e marrëdhënies me EQSC, dhe azhurnimin për sa herë ka konflikt të interesit ose për të paktën çdo dy vjet) FPO.2\_1 Deklarata e paanshmërisë, konfidencialitetit dhe konfliktit të interesit (shih pikën 2.2 më poshtë).

### 3.2 Konflikti i interesit

EQSC vepron i lirë ndaj çdo ndikimi nga interesa të ndryshme. Për të siguruar paanshmërinë dhe objektivitetin e tij EQSC ka një politikë strikte që ka të bëjë me konfliktin e interesave të të gjithë personelit të përfshirë në aktivitetet e auditimit dhe certifikimit.

Konflikti i interesave lind nëse personi i përfshirë në procesin e certifikimit ka marrëdhënie financiare ose personale me një person ose organizatë, marrëdhënie e cila mund të përfundojë në një konflikt, p.sh. anëtarët e familjes, miqtë, partnerë biznesi, konkurrentë, etj. Konflikti i interesit mund të jetë edhe

“pozitiv” domethënë mund të ketë një interes për një vendim pozitiv certifikimi; ose “negativ” domethënë individit mund të jetë kundër certifikimit, p.sh. për arsye konkurrence.

Personat me konflikt të interesave duhet të përjashtohen nga procesi i certifikimit, në të gjitha nivelet që lidhen me operatorin, aty ku ekziston konflikti. Kjo politikë prek të gjitha personat e përfshirë në procesin e auditimit dhe certifikimit p.sh. stafin, auditorët, anëtarët e komiteteve ose palët e nënkontraktuara.

Konflikti i interesit mund të ndodhë edhe në rastin kur një person (anëtar i personelit ose komitetit) jep këshilla ose i siguron konsulentë një klienti gjatë 2 viteve të mëparshme.

Të gjithë personat (anëtarë komitetesh dhe personel) të përfshirë në procesin e auditimit/certifikimit duhet të plotësojnë FPO.2\_1 Deklarata e paanshmërisë, konfidencialitetit dhe konfliktit të interesit. Kjo deklaratë duhet të plotësohet dhe azhurnohet në dosjet e secilit person përkatës, në çdo herë që ka konflikt të interesit, ose të paktën çdo dy vjet.

MCI verifikon këto deklarime dhe i raporton Administratorit. Administratori vendos nëse ka potencial për një konflikt të interesit ose jo dhe delegon MCI të përjashtojë personin me konflikt të interesit, nga çdo aktivitet që mund të përbëjë rrezik për paanshmërinë e vendimeve të marra nga EQSC për rastin specifik. Këta individë janë të detyruar të mos marrin pjesë në çfarëdo aktiviteti që ka lidhje me procesin e certifikimit të rastit specifik.

Personat që kanë realizuar auditime ose kanë qenë të përfshirë në procesin e certifikimit të një klienti me të cilin ata kishin konflikt të interesit, dhe për të cilin nuk deklaruan më parë, mund të përjashtohen menjëherë nga çdo komitet i EQSC ose do t'i ndërpritet kontrata e punës sipas vendimit të Administratorit.

Komiteti i Paanshmërisë i raportohet çdo vit në takimin përkatës, të gjitha rastet e konfliktit të interesit dhe masat e marra.

### 3.3 Konfidencialiteti (mirëbesimi)

EQSC garanton konfidencialitetin mbi të gjithë informacionin për klientët, të marrë gjatë aktiviteteve të certifikimit, në të gjitha nivelet e tij duke përfshirë komitetet, palët e nënkontraktuara dhe stafin.

Personat ose anëtarët e komiteteve të cilët janë pjesë e proceseve të auditimit dhe/ose certifikimit, marrin informacion si dhe kanë akses ndaj të gjithë informacionit dhe dokumenteve të klientëve dhe dokumenteve të tjera konfidenciale. Anëtarët e Komitetit të Paanshmërisë, me përjashtim të rastit kur janë anëtarë të komiteteve të tjera, nuk kanë akses në të dhënat e mësipërme.

Të gjithë personat që kanë akses në të dhënat e certifikimit, duke përfshirë personat e jashtëm si psh ekspertët, si dhe të gjithë anëtarët e komiteteve bien dakort të ruajnë konfidencialitetin (mirëbesimin) nëpërmjet nënshkrimit të FPO.2\_1.

Informacioni mbi klientët dhe veprimtarinë e tyre nuk do të shfaqet pa miratimin e tyre. Ky informacion përfshin detajet që lidhen me veprimtarinë, raportin e auditimit, etj.

Megjithatë ky informacion mund të vihet në dispozicion të trupave certifikuese, autoriteteve dhe trupave të tjera me të drejta ligjore për të kontrolluar të dhënat e certifikimit. EQSC mban të drejtën për të informuar palët e interesuar, në bazë të kërkesës, mbi emrat e klientëve të certifikuar, adresat e tyre, arsyet e certifikimit dhe produktet e mbuluara nga certifikimi.